



01 Nr. 650/25 Dt. 22.12.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 paragrafi g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 37 të Ligjit 06/L-82, për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për zëvendësimin e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale

1. Adelina Hoxhaj, zyrtare për dokumentacion dhe informim në Njësinë për Komunikim me Publikun në Komunën e Prizrenit, e zëvendëson Adonita Karavidaj- zyrtare ligjor në Komunën e Prizrenit, e cila është e caktuar me vendim 01 nr. 479/25, datë 05.08.2025, si zyrtare për mbrojtjen e të dhënave personale në Komunën e Prizrenit.
2. Detyra dhe përgjegjësit e zyrtares të caktuar në pikën 1 të këtij Vendimi janë të parapara në Ligjin 06/L-82, për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe aktet nënligjore që e rregullojnë këtë lëmi.
3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
4. Obligohen zyrtarët përkatës për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij dhe vlen deri në kthimin e zyrtares për mbrojtjen e të dhënave personale në Komunën e Prizrenit, nga pushimi pa pagesë ose deri në revokimin e këtij vendimi.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Të lartcekurve,
 - Agjencisë për Informim dhe Privatësi,
 - Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore,
 - Arkivës së Kryetarit.